



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

**Akte të papublikuara**

**1997**

**Ekstra 17**

### P Ë R M B A J T J A

Faqe

|                                        |                                                                                                                                                                                                         |   |
|----------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---|
| Vendim i KM<br>nr.51, datë<br>3.2.1997 | Për një shtesë në buxhetin e Ministrisë së Brendshme për riparimin e helikopterëve të kësaj Ministrie .....                                                                                             | 5 |
| Vendim i KM<br>nr.52, datë<br>3.2.1997 | Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Argjentinës për heqjen e vizave nga pasaportat diplomatike dhe zyrtare ose të shërbimit”.....  | 5 |
| Vendim i KM<br>nr.53, datë<br>3.2.1997 | Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Kilit për heqjen e vizave nga pasaportat diplomatike, zyrtare, speciale dhe të shërbimit”..... | 5 |
| Vendim i KM<br>nr.54, datë<br>3.2.1997 | Për prokurimin e drejtpërdrejtë për blerjen e kablllove.....                                                                                                                                            | 6 |
| Vendim i KM<br>nr.55, datë<br>3.2.1997 | Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.38, datë 15.1.1996 “Për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik”.....                  | 6 |
| Vendim i KM<br>nr.56, datë<br>3.2.1997 | Për pagesën e punonjësve të shoqërisë anonime “Sheqeri” në Maliq, të cilët dalin të papunë nga ndërprerja e veprimtarisë prodhuese të kësaj shoqërie.....                                               | 7 |

|                                          |                                                                                                                                                                                                                                                                            |    |
|------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Vendim i KM<br>nr.57, datë<br>3.2.1997   | Për ndryshimin e pagës së sekretareve të komisioneve të përhershme<br>parlamentare .....                                                                                                                                                                                   | 7  |
| Vendim i KM<br>nr.59, datë<br>3.2.1997   | Për akordim fondi për periudhën janar-mars të vitit 1997 për partitë<br>politike.....                                                                                                                                                                                      | 8  |
| Vendim i KM<br>nr.65, datë<br>11.2.1997  | Për përfundimin e rikonstruksionit të godinës së Gjykatës së<br>Kasacionit.....                                                                                                                                                                                            | 8  |
| Vendim i KM<br>nr.66, datë<br>11.2.1997  | Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.560, datë<br>16.10.1995 “Për masat për zbatimin e ligjit nr.7699, datë 21.4.1993 “Për<br>kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës<br>bujqësore”.....                                                     | 9  |
| Vendim i KM<br>nr.67, datë<br>11.2.1997  | Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.445, datë<br>13.12.1991 “Për vërtetimin e kohës së vuajtjes së dënimit administrativ nga<br>ish-të internuarit e të dëbuarit për çështje politike kur mungojnë<br>dokumentet zyrtare”.....                       | 9  |
| Vendim i KM<br>nr.68, datë<br>17.2.1997  | Për prokurim të drejtpërdrejtë.....                                                                                                                                                                                                                                        | 10 |
| Vendim i KM<br>nr.69, datë<br>17.2.1997  | Për një shtesë në limitin organik të Ministrisë së Brendshme.....                                                                                                                                                                                                          | 10 |
| Vendim i KM<br>nr.70, datë<br>17.2.1997  | Për një shtesë në planin e buxhetit të ndihmës ekonomike.....                                                                                                                                                                                                              | 11 |
| Vendim<br>nr.71, datë<br>3.2.1997        | Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433, datë<br>3.9.1993 “Për ndalimin e importimit të gomave të përdorura”                                                                                                                                       | 11 |
| Vendim i KM<br>nr.72, datë<br>17.2.1997  | Për miratimin e ndihmës ushqimore nga Republika e Italisë.....                                                                                                                                                                                                             | 12 |
| Vendim i KM<br>nr.76, datë<br>17.2.1997  | Për anulimin e fillimit të procedurës së shitjes së librarisë pranë Bankës në<br>Tiranë.....                                                                                                                                                                               | 12 |
| Vendim i KM<br>nr.77, datë<br>20.1.1997  | Për ngarkimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ambientit për zbatimin e<br>projektit të programit life.....                                                                                                                                                             | 12 |
| Vendim i KM<br>nr.78, datë<br>17.2.1997  | Për ndihmën e shtetit për qytetarët që kanë shitur shtëpitë dhe kanë<br>depozituar paratë në fondacionet ose kompanitë huamarrëse që kanë<br>falimentuar.....                                                                                                              | 13 |
| Vendim i KM<br>nr. 82, datë<br>11.2.1997 | Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.226, datë<br>9.4.1996 “Për shkëmbimin për efekt kompensimi të truallit dhe të vilës<br>nr.6, pronë e shtetit shqiptar me truallin dhe vilën nr.30, pronë e Mbretërisë<br>së Bashkuar të Britanisë së Madhe”..... | 13 |

|                                          |                                                                                                                                                                                                                       |    |
|------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Vendim i KM<br>nr. 83, datë<br>24.2.1997 | Për ngritjen dhe funksionimin e njësive për zbatimin e projektit në Institutin e Statistikës .....                                                                                                                    | 14 |
| Vendim i KM<br>nr. 84, datë<br>24.2.1997 | Për miratimin në parim të projekt marrëveshjes për heqjen e vizave për pasaportat diplomatike dhe të shërbimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Ukrainës.....                            | 14 |
| Vendim i KM<br>nr. 85, datë<br>24.2.1997 | Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.18, datë 13.1.1997 “Për prokurimin me fonde shtetërore për prodhimin e kalemave të kultivarëve autoktonë të vreshtarisë”....                              | 15 |
| Vendim i KM<br>nr. 86, datë<br>24.2.1997 | Për blerjen me prokurim të drejtpërdrejtë nga Instituti i Kërkimeve Veterinare të vaksinës kundër murtajës klasike të derrave .....                                                                                   | 15 |
| Vendim i KM<br>nr. 87, datë<br>24.2.1997 | Për miratimin në parim të projektit të shëndetit riprodhues me fondin e Kombeve të Bashkuara për veprimtaritë e popullsisë (UNFPA).....                                                                               | 16 |
| Vendim i KM<br>nr. 88, datë<br>24.2.1997 | Për miratimin në parim të projekt marrëveshjes për bashkëpunimin financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin e planifikimit familjar..... | 16 |
| Vendim i KM<br>nr. 89, datë<br>24.2.1997 | Për prokurim të drejtpërdrejtë.....                                                                                                                                                                                   | 17 |
| Vendim i KM<br>nr. 90, datë<br>24.2.1997 | Për një shtesë në fondet e kushtëzuara për Buxhetin e Shtetit për periudhën janar-mars 1997.....                                                                                                                      | 17 |
| Vendim i KM<br>nr. 96, datë<br>24.2.1997 | Për pagesën e të punësuarve të portit detar të Durrësit, të cilët dalin të papunë, si pasojë e zbatimit të projektit të ristrukturimit të këtij porti.....                                                            | 18 |
| Vendim i KM<br>nr. 97, datë<br>3.2.1997  | Për miratimin në parim të ndryshimeve në marrëveshjen e kredisë së zhvillimit ndërmjet Shqipërisë dhe IDA-s për projektin e transportit.....                                                                          | 18 |
| Vendim i KM<br>nr. 98, datë<br>24.2.1997 | Për një transferim fondesh buxhetore .....                                                                                                                                                                            | 18 |

**VENDIM**  
**Nr.51, datë 3.2.1997**

**PËR NJË SHITESË NË BUXHETIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR RIPARIMIN E  
HELIKOPTERËVE TË KËSAJ MINISTRIE**

Me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për riparimin e helikopterëve të Ministrisë së Brendshme, miratohet prokurimi i drejtpërdrejtë me firmën prodhuese “EUROCOPTER FRANCE” për një fond deri në 50 milionë lekë.
  2. Fondi sipas pikës 1 të këtij vendimi të përballohet brenda fondeve buxhetore të Ministrisë së Brendshme për vitin 1997
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr.52, datë 3.2.1997**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË  
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË ARGJENTINËS PËR HEQJEN E  
VIZAVE NGA PASAPORTAT DIPLOMATIKE DHE ZYRTARE OSE TË SHËRBIMIT”**

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Argjentinës për heqjen e vizave nga pasaportat diplomatike dhe zyrtare ose të shërbimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr.53, datë 3.2.1997**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË  
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË KILIT PËR HEQJEN E VIZAVE NGA  
PASAPORTAT DIPLOMATIKE, ZYRTARE, SPECIALE DHE TË SHËRBIMIT”**

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Kilit për heqjen e vizave nga pasaportat diplomatike, zyrtare, speciale dhe të shërbimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Mexsi**

**VENDIM**  
**Nr.54, datë 3.2.1997**

**PËR PROKURIMIN E DREJTPËRDREJTË PËR BLERJEN E KABLLOVE**

Në mbështetje të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, neni 17 pika 3, me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shoqëria anonime “KESH”, për nevojat e emergjencës në periudhën e dimrit, të prokurojë drejtpërsëdrejti në uzinën e kabllove në Shkodër për blerjen e 50 tonëve kablo me një vlerë prej 22.5 milionë lekësh.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Mexsi**

**VENDIM**  
**Nr.55, datë 3.2.1997**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.38, DATË 15.1.1996 “PËR DEKLARIMIN E PASURIVE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA DREJTUESVE E PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PUBLIK”**

Me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.38, datë 15.1.1996 “Për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve të shërbimit publik”, në pikën 12 shkronja “e” shtohet ky paragraf:

“Deklaratës i bashkëngjitet edhe certifikata e gjendjes familjare që sigurohet nga vetë deklaruesi (originale ose fotokopje e noterizuar), e cila duhet të pasqyrojë gjendjen dhe ndryshimet për të 12 muajt e vitit, për të cilët deklarohet pasuria”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Mexsi**

**VENDIM**  
**Nr.56, datë 3.2.1997**

**PËR PAGESËN E PUNONJËSVE TË SHOQËRISË ANONIME “SHEQERI” NË MALIQ, TË CILËT DALIN TË PAPUNË NGA NDËRPRERJA E VEPRIMTARISË PRODHUESE TË KËSAJ SHOQËRIE**

Për të rregulluar pagesat e punonjësve të shoqërisë anonime “Sheqeri” në Maliq, të cilët dalin

të papunë nga ndërprerja e veprimtarisë ekonomike të kësaj shoqërie, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, të Ministrisë së Privatizimeve dhe të Ministrisë së Bujqësisë e të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Punonjësit e shoqërisë anonime “Sheqeri” në Maliq, të cilët kanë dalë të papunë gjatë periudhës 1.11.1996 gjer më 31.3.1997, përfitojnë të drejtën e trajtimit për një vit me pagën e vendit të fundit të punës, sipas zbërthimit që shoqëria i ka bërë pagës mesatare mujore për efekt kontrolli, të miratuar për vitin 1996 e në vazhdim, por kjo pagë mesatare, mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.389, datë 12.7.1995, nuk duhet të jetë mbi 7 mijë lekë në muaj.

2. Përfitojnë nga ky vendim punonjësit që kanë qenë të punësuar në sektorët e shoqërisë anonime “Sheqeri” në Maliq në mënyrë të pandërprerë, në një periudhë kohe jo më pak se një vit dhe ndodhen të punësuar në këta sektorë gjatë periudhës 1.11.1996 gjer më 31.3.1997.

Të drejtën e trajtimit e kanë punonjësit që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike në formën e punësimit a të vetëpunësimit, nuk kanë tokë të mjaftueshme në pronësi ose përdorim, si dhe janë të gatshëm e pranojnë të marrin pjesë në punë të nevojshme publike të organizuara në nivel lokal.

Këta punonjës përfitojnë të gjitha kompensimet sipas dispozitave në fuqi.

3. Fondet financiare prej 40 milionë lekësh për kryerjen e pagesave të punonjësve sipas këtij vendimi, si dhe për pagesat ndaj sigurimeve shoqërore, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punës dhe i Çështjeve Sociale për vitin 1997.

4. Periudha e trajtimit të punonjësve sipas këtij vendimi quhet vjetërsi pune për efekt pensioni dhe shënohet si e tillë në librezën e punës. Për punonjësit e trajtuar me këtë pagesë derdhen të gjitha llojet e kontributeve, siç përcaktohet në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

5. Pagesat kryhen nga zyrat e punësimit të rretheve, duke u mbështetur në një dokumentacion të caktuar, i cili përcaktohet me udhëzim të veçantë.

6. Punonjësit që janë të trajtuar një herë sipas kriterëve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.420, datë 15.8.1994, nuk do të përfitojnë të drejtën e trajtimit sipas kriterëve të këtij vendimi.

7. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Privatizimeve të nxjerrin udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

#### VENDIM Nr.57, datë 3.2.1997

#### PËR NDRYSHIMIN E PAGËS SË SEKRETAREVE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PARLAMENTARE

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore” në lidhjen II-3 “Pagat mujore dhe renditja e detyrave sipas klasave për punonjësit e Kryesisë së Kuvendit Popullor”, në numrin rendor 10 shtohet emërtimi “Sekretar i komisionit të përhershëm parlamentar .”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr.59, datë 3.2.1997**

**PËR AKORDIM FONDI PËR PERIUDHËN JANAR-MARS TË VITIT 1997 PËR PARTITË POLITIKE**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për periudhën janar-mars të vitit 1997 partive politike u akordohet një fond prej 40 milionë lekësh.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, i përcaktuar në buxhetin e përkohshëm të periudhës janar-mars të vitit 1997  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr.65, datë 11.2.1997**

**PËR PËRFUNDIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË GODINËS SË GJYKATËS SË KASACIONIT**

Me propozimin e Gjykatës së Kasacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Për të përfunduar rikonstruksionin dhe zgjerimin e ambienteve të godinës së Gjykatës së Kasacionit, si objekt në vazhdim nga viti 1996, akordohet një fond investimi në masën 17 milionë lekë.

Ky fond të përballohet nga plani i buxhetit për investimet për 3-mujorin e parë të vitit 1997.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr.66, datë 11.2.1997**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.560, DATË 16.10.1995 “PËR MASAT PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7699, DATË 21.4.1993 “PËR KOMPENSIMIN NË VLERË TË ISH-PRONARËVE TË TOKËS BUJQËSORE”**

Në zbatim të nenit 4 të ligjit nr.7699, datë 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë ose me troje të ish-pronarëve të tokave bujqësore, kullotave, livadheve, tokave pyjore dhe pyjeve”, me propozimin e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.560, datë 16.10.1995, ndryshuar me vendimin nr.438, datë 17.6.1996, pika 5/1 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Pretendentët ish-pronarë të kullotave, livadheve, tokave pyjore e pyjeve, në zbatim të neneve 4, 7/1, 7/2 dhe 7/3 të ligjit nr.7699, datë 21.4.1993, duhet të hapin dosje të veçanta, të cilat krahas dokumenteve të përcaktuara në shkronjat “b”, “c” dhe “d” të pikës 5, të përmbajnë edhe këto dokumente:

a) Aktet e pronësisë të lëshuara nga zyrat e hipotekës ose kadastrës, me të cilat vërtetohet se kanë qenë pronarë deri në momentin e daljes së ligjit nr.108, datë 29.8.1945.

Në mungesë të tyre pronësia do të vërtetohet me vendim të gjykatës së rrethit përkatës.

b) Planvendosjen e bërë nga kadastra, me kufizimet sipas dokumentacionit të pronësisë.

c) Vërtetimin e lëshuar nga drejtoritë e shërbimit pyjor ose kadastral në rrethe, me të cilin përcaktohet gjendja kadastrale në datën 1.8.1991 për sipërfaqen e pretenduar”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr.67, datë 11.2.1997**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.445, DATË 13.12.1991 “PËR VËRTETIMIN E KOHËS SË VUAJTJES SË DËNIMIT ADMINISTRATIV NGA ISH-TË INTERNUARIT E TË DËBUARIT PËR ÇËSHTJE POLITIKE, KUR MUNGOJNË DOKUMENTET ZYRTARE”**

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.445, datë 13.12.1991 pika 3 të bëhet si vijon:

“Qenia i internuar ose i dëbuar mund të vërtetohet në rrugë administrative nga komisioni përkatës deri në datën 30.6.1997”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr.68, datë 17.2.1997**

**PËR PROKURIM TË DREJTPËRDREJTË**

Me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratohet që Ministria e Brendshme të prokurojë drejtpërdrejt me artikujt vijues:

|            |                 |                |
|------------|-----------------|----------------|
| - Oriz     | në fondin limit | 5 650 000 lekë |
| - Fasule   | në fondin limit | 4 750 000 lekë |
| - Makarona | në fondin limit | 4 550 000 lekë |
| - Vaj      | në fondin limit | 6 400 000 lekë |
| - Sheqer   | në fondin limit | 2 900 000 lekë |

|                                                                       |                 |                 |
|-----------------------------------------------------------------------|-----------------|-----------------|
| - Çizme ushtari me firmën "Recor-Albania" Gjirokastrë                 | në fondin limit | 8 190 000 lekë  |
| - Pajisje speciale të policisë me firmën "MICEI FORTEND USA" Maqedoni | në fondin limit | 50 000 000 lekë |
| - Krevate marinari                                                    | në fondin limit | 2 000 000 lekë  |
| - Dyshek dhe jastëkë                                                  | në fondin limit | 4 000 000 lekë  |

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr.69, datë 17.2.1997**

**PËR NJË SHITESË NË LIMITIN ORGANIK TË MINISTRISË SË BRENDSHME**

Me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në limitin organik të Ministrisë së Brendshme shtohen 500 funksione për forcat e ndërhyrjes së shpejtë dhe repartet e gatishmërisë së rendit.
2. Përdorimi i limitit të mësipërm bëhet sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministri i Brendshëm.
3. Për efekt të zbatimit të këtij vendimi, në buxhetin e tremujorit të parë të vitit 1997 të Ministrisë së Brendshme shtohen 45.5 milionë lekë, nga të cilat 16 milionë lekë fond page, 23 milionë lekë shpenzime operative dhe 6.5 milionë lekë për investime, që përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave i planifikuar për 3-mujorin e parë të vitit 1997.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e zbatimit të tij shtrihen që nga data 10.2.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr.70, datë 17.2.1997**

**PËR NJË SHITESË NË PLANIN E BUXHETIT TË NDIHMËS EKONOMIKE**

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në buxhetin e ndihmës ekonomike për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale për 3-mujorin e parë të vitit 1997 të shtohet shuma 90 milionë lekë, e cila të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave të parashikuar për 3-mujorin e parë të vitit 1997.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr.71, datë 3.2.1997**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.433, DATË 3.9.1993 “PËR NDALIMIN E IMPORTIMIT TË GOMAVE TË PËRDORURA”**

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Paragrafi i dytë i pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.433, datë 3.9.1993, ndryshohet si vijon:

“Përfshihen nga ky vendim gomat e riveshura, ato që importohen me destinacion riveshjen e tyre nga subjektet e licencuara për këtë veprimtari, si dhe gomat e montuara në mjetet që importohen”.

2. Shtohet pika 1/a me këtë përmbajtje:

“Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit të përcaktojnë sasinë vjetore të gomave që importohen për riveshje dhe sasinë për çdo subjekt të specifikuar për çdo tremujor, në përputhje me aftësinë riveshëse të çdo subjekti të licencuar nga këto dy ministri”.

3. Pika 2 ndryshohet si vijon:

“Ngarkohet Ministria e Financave, Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit të përcaktojnë rregullat përkatëse për zbatimin e këtij vendimi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr.72, datë 17.2.1997**

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS USHQIMORE NGA REPUBLIKA E ITALISË**

Me propozimin e Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Të miratojë në parim propozimin për marrje të ndihmës ushqimore nga Republika e Italisë.

2. Autorizohet Departamenti i Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj t'i paraqesë Ambasadës së Republikës të Italisë kërkesën zyrtare në emër të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit për arritjen e marrëveshjes dhe zbatimin e saj në përputhje me rregullat në fuqi.

4. Çmimet e shitjes të këtyre mallrave i miraton Kryetari i Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

5. Të ardhurat e realizuara nga kjo ndihmë të kalojnë si shtesë e fondit rezervë të Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr.76, datë 17.2.1997**

**PËR ANULIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURËS SË SHITJES SË LIBRARISË PRANË  
BANKËS NË TIRANË**

Me propozimin e Ministrisë së Privatizimeve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të anulohet fillimi i procedurës së librarisë pranë Bankës në Tiranë.
  2. Në pikën 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.328, datë 6.5.1996 “Për privatizimin dhe dhënien me qira të objekteve pronë shtetërore të njërive të tregtimit të librit artistik dhe shkollor”, shtohet “...Libraria pranë Bankës në Tiranë”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr.77, datë 20.1.1997**

**PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE TË MBIENTIT PËR  
ZBATIMIN E PROJEKTIT TË PROGRAMIT LIFE**

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ambientit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ambientit për të zbatuar projektin “Organizimi i administrimit të mbetjeve urbane në 6 bashki kryesore të Shqipërisë: një model i zbatueshëm edhe për qytetet e vendeve të tjera në zhvillim”.
  2. Krijimin e komitetit drejtues për monitorimin e projektit me përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit, Sekretariati Shtetëror i Pushtetit Lokal, Ministria e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Departamenti i Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj, si dhe bashkitë e përfshira në projekt.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr.78, datë 17.2.1997**

**PËR NDIHMËN E SHTETIT PËR QYTETARËT QË KANË SHITUR SHTËPITË DHE  
KANË DEPOZITUAR PARATË NË FONDACIONET OSE KOMPANITË HUAMARRËSE  
QË KANË FALIMENTUAR**

Me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Gjithë qytetarët që kanë shitur apartamentet e tyre dhe kanë depozituar paratë në

fondacionet a kompanitë huamarrëse që kanë falimentuar, quhen të pastrehë dhe do të përfitojnë sipas ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”.

2. Bashkitë të ngrenë menjëherë komisionet përkatëse, të hartojnë listat e qytetarëve, të verifikojnë dokumentacionin përkatës, t’i miratojnë ato në këshillin bashkiak dhe t’i dërgojnë në Bankën e Kursimeve, e cila t’i trajtojë ato me përparësi të veçantë.

3. Në qoftë se qytetarët kanë përfituar pjesërisht nga fondacionet ose kompanitë huamarrëse të falimentuara, masa e përfitimit falas nga shteti do të llogaritet sipas ligjit nr.8030, datë 15.11.1995, duke u zbritur pjesën që ata kanë përfituar pjesërisht.

4. Nëse qytetarët e mësipërm do të përfitojnë nga likuidimi i pasurive të fondacioneve e kompanive huamarrëse të falimentuara, nga shuma e përfitimit do t’u zbritet pjesa që ata kanë përfituar falas nga shteti tërësisht a pjesërisht sipas rastit dhe kurdo që ajo do të ndodhë.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të nxjerrin udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr. 82, datë 11.2.1997**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.226, DATË 9.4.1996 “PËR SHKËMBIMIN PËR EFEKT KOMPENSIMI TË TRUALLIT DHE TË VILËS NR.6, PRONË E SHTETIT SHQIPTAR ME TRUALLIN DHE VILËN NR.30, PRONË E MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE”**

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Pika 1 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.226, datë 9.4.1996 “Për shkëmbimin për efekt kompensimi të truallit dhe të vilës nr.6, pronë e shtetit shqiptar me truallin dhe vilën nr.30, pronë e Mbretërisë së Britanisë së Madhe”, ndryshohet si vijon:

“Të bëhet shkëmbimi për efekt kompensimi i vilës aktuale nr.6, që rrethohet nga një oborr prej 1640 m<sup>2</sup>, pronë e shtetit shqiptar me vilën nr.30 e rrethuar nga një oborr me sipërfaqe prej 4307,54 m<sup>2</sup>, pronë e shtetit britanik. Në këtë mënyrë përfaqësia britanike kalon nga vila nr.30 me oborrin përreth në vilën nr.6 me oborrin përreth”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr. 83, datë 24.2.1997**

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E NJËSISË PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT NË INSTITUTIN E STATISTIKËS**

Me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Për zbatimin e projektit të modernizimit të statistikave në kuadrin e Programit Kombëtar PHARE 1996, ngarkohet Instituti i Statistikës të ngrejë njësinë për zbatimin e projektit (PIU) dhe të vërë në dispozicion personelin dhe mjediset e nevojshme.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngakohen Ministria e Financave dhe Instituti i Statistikës.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr. 84, datë 24.2.1997**

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTMARRËVESHJES PËR HEQJEN E VIZAVE  
PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT NDËRMJET QEVERISË SË  
REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË UKRAINËS**

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin në parim të projekt marrëveshjes për heqjen e vizave për pasaportat diplomatike dhe të shërbimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Ukrainës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr. 85, datë 24.2.1997**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.18, DATË  
13.1.1997 “PËR PROKURIMIN ME FONDE SHTETËRORE PËR PRODHIMIN E  
KALEMAVE TË KULTIVARËVE AUTOKTONË TË VRESHTARISË”**

Me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.18, datë 13.1.1997, hiqen fjalët “... miratuar nga Këshilli i Ministrave”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/a me këtë përmbajtje:

“Për fazën e parë të emergjencës për vreshtarinë Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit i shtohen 7 milionë lekë që përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave i parashikuar për 3-mujorin e parë të vitit 1997”.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr. 86, datë 24.2.1997**

**PËR BLERJEN ME PROKURIM TË DREJTPËRDREJTË NGA INSTITUTI I KËRKIMEVE  
VETERINARE TË VAKSINËS KUNDËR MURTAJËS KLASIKE TË DERRAVE**

Në zbatim të nenit 38 të ligjit nr.7674, datë 23.2.1993 “Për shërbimin dhe inspektoratin veterinar”, nenit 17 pika 3 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autorizohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit që, nëpërmjet Institutit të Kërkimeve Veterinare, të prokurojë drejtpërdrejt për blerjen e vaksinës kundër murtajës klasike të derrave jashtë shtetit.

2. Fondi përkatës është i miratuar në buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit për tremujorin e parë të vitit 1997.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr. 87, datë 24.2.1997**

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTIT TË SHËNDETIT RIPODHUES ME  
FONDIN E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR VEPRIMTARITË E POPULLSISË (UNFPA)**

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ambientit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin në parim të projektit të shëndetit riprodhues me Fondin e Kombeve të Bashkuara për veprimtaritë e popullsisë (UNFPA)

2. Ngritjen e njësive të zbatimit të projektit dhe pagat e punonjësve të saj të jenë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.677, datë 4.9.1995 “Për caktimin e pagave të personelit të njësive zbatuese të projekteve, kredive apo ndihmave akorduar Qeverisë shqiptare nga institucione ndërkombëtare ose qeveri të vendeve të ndryshme

3. Autorizohet Ministri i Shëndetësisë dhe i Ambientit, ose i autorizuari i tij, të nënshkruajë projektin e shëndetit riprodhues me Fondin e Kombeve të Bashkuara për veprimtaritë e popullsisë (UNFPA).

4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit të ndjekë zbatimin e projektit të shëndetit riprodhues.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr. 88, datë 24.2.1997**

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTMARRËVESHJES PËR BASHKËPUNIMIN  
FINANCIAR NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË  
SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR PROJEKTIN E PLANIFIKIMIT  
FAMILJAR**

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ambientit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të projekt marrëveshjes për bashkëpunim financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin e planifikimit familjar, me ndryshimin e nenit 3 si vijon:

“Qeveria shqiptare merr përsipër pagesën e taksave dhe tatimeve për mallrat që do të livrohen në kuadrin e kësaj marrëveshjeje, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë”.

2. Autorizohet Ministri i Shëndetësisë dhe i Ambientit, ose i autorizuari i tij, të nënshkruajë marrëveshjen e bashkëpunimit financiar në emër të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.

3. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit të ndjekë zbatimin e projektit të planifikimit familjar.

4. Ngarkohet Ministria e Financave të parashikojë në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ambientit fondet e nevojshme për mbulimin e detyrimeve sipas nenit 3 të projekt marrëveshjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**

**Nr. 89, datë 24.2.1997**

**PËR PROKURIM TË DREJTPËRDREJTË**

Me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Të autorizojë Ministrinë e Brendshme që, për plotësimin e nevojave të shtesës së organikës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 17.2.1997, të prokurojë drejtpërdrejt:

a) Për artikujt

|                                     |           |
|-------------------------------------|-----------|
| - Çarçafë                           | 2000 copë |
| - Jastëkë                           | 500 copë  |
| - Këllëfë jastëku                   | 1000 copë |
| - Peshqirë                          | 500 copë  |
| - tavolina mense                    | 65 copë   |
| - Karrige                           | 250 copë  |
| - Tavolina zyre                     | 25 copë   |
| - Karrige zyre                      | 35 copë   |
| - Frigoriferë me ngrirje të thellë  | 2 copë    |
| - Soba ekonomike me gaz dhe korrent | 2 copë    |

b) Për rikonstruksionin dhe përshtatjen e mjediseve, në fondin limit

5 milionë lekë

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr. 90, datë 24.2.1997**

**PËR NJË SHITESË NË FONDET E KUSHTËZUARA PËR BUXHETIN E SHTETIT PËR  
PERIUDHËN JANAR-MARS 1997**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në zërin “fonde të kushtëzuara” për Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal shtohen 70 milionë lekë. Ngarkohet Sekretariati Shtetëror për Pushtetin Lokal për detajimin e këtij fondi për çdo organ të pushtetit lokal.
  2. Në zërin “fonde të kushtëzuara” Drejtorisë së Doganave i shtohen 10 milionë lekë. Ky fond do të përdoret për investimet në proces të kësaj drejtorie.
  3. Në zërin “fonde të kushtëzuara” Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit i shtohen 4 milionë lekë. Ky fond do të përdoret për investimet në proces të kësaj drejtorie.
  4. Fondi prej 84 milionë lekësh përballohet nga zëri kontingjencë, parashikuar në buxhetin e 3-mujorit të parë të vitit 1997.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr. 96, datë 24.2.1997**

**PËR PAGESËN E TË PUNËSUARVE TË PORTIT DETAR TË DURRËSIT, TË CILËT  
DALIN TË PAPUNË SI PASOJË E ZBATIMIT TË PROJEKTIT TË RISTRUKTURIMIT TË  
KËTIJ PORTI**

Për të rregulluar pagesat e të punësuarve të portit detar të Durrësit, të cilët dalin të papunë si pasojë e ristrukturimit të tij, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe të Ministrisë së Industrisë, Transportit e Tregtisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Të punësuarit në portin detar të Durrësit, të cilët dalin të papunë gjatë periudhës 1.1.1997 gjer më 1.10.1997, përfitojnë të drejtën e pagesës për një vit me pagën mesatare mujore të vitit të fundit të punës, por duke mos kaluar shumën 7000 lekë në muaj.
2. Përfitojnë nga ky vendim të punësuarit në portin detar të Durrësit, të cilët kanë qenë të punësuar në këtë ndërmarrje në mënyrë të pandërprerë për një periudhë kohe jo më pak se 1 vit dhe ndodhen të punësuar në të gjatë periudhës 1.1.1997 gjer më 1.10.1997.
- Të drejtën e trajtimit e kanë të punësuarit që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike, qoftë edhe përkohësisht, në formën e punësimit apo të vetëpunësimit, nuk kanë tokë të mjaftueshme në pronësi a përdorim, si dhe janë të gatshëm e pranojnë të marrin pjesë në punë të nevojshme publike të organizuara në nivel lokal.
- Këta të punësuar përfitojnë të gjitha kompensimet sipas dispozitave në fuqi.
3. Të drejtën e trajtimit nuk e kanë të punësuarit që largohen nga puna për shkaqe që nuk kanë lidhje me zbatimin e projektit të ristrukturimit të portit detar të Durrësit, si dhe ata që janë trajtuar një herë sipas kritereve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.420, datë 15.8.1994.
4. Fondet financiare për kryerjen e pagesave të punësuarve sipas këtij vendimi, duke përfshirë edhe sigurimet shoqërore për këta punonjës, do të përballohen nga porti detar i Durrësit.
5. Periudha e trajtimit të të punësuarve sipas këtij vendimi konsiderohet vjetërsi pune për efekt pensioni dhe shënohet si e tillë në librezën e punës. Për të punësuarit e trajtuar me këtë pagesë derdhen të gjitha llojet e kontributeve, siç përcaktohet në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet

shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

6. Pagesat kryhen nga zyrat e punësimit të rretheve, duke u mbështetur në një dokumentacion që përcaktohet me udhëzim të veçantë.

7. Ngarkohen Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë dhe Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale të nxjerrin udhëzimin për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr. 97, datë 3.2.1997**

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË NDRYSHIMEVE NË MARRËVESHJEN E KREDISË SË ZHVILLIMIT NDËRMJET SHQIPËRISË DHE IDA-S PËR PROJEKTIN E TRANSPORTIT**

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Të miratojë në parim Letrën e Kredisë ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA) për ndryshimin në marrëveshjen e kredisë së zhvillimit ndërmjet Shqipërisë dhe IDA-s për projektin e transportit.

2. Autorizohet Ministri i Financave, ose i autorizuari i tij, të nënshkruajë, në emër të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, Letrën e Kredisë.

3. Ngarkohet Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë për përdorimin e fondit prej 1 milion USD, sipas kushteve të marrëveshjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**VENDIM**  
**Nr. 98, datë 24.2.1997**

**PËR NJË TRANSFERIM FONDESH BUXHETORE**

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në buxhetin e Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale për vitin 1997 bëhen këto ndryshime:

a) I pakësohen fondit të ndihmës ekonomike 8000 mijë lekë.

b) U shtohen institucioneve të përkujdesit shoqëror shpenzimet e buxhetit për vitin 1997, 8000 mijë lekë, nga të cilat 5000 mijë lekë fond page dhe 3000 mijë lekë shpenzime operative.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Financave dhe Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
  - Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".  
Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

**BOTIMET:**

|     |                                      |      |
|-----|--------------------------------------|------|
| 1.  | KUSHTETUTA (edhe anglisht)           | 600  |
| 2.  | KODI I PROCEDURËS CIVILE             | 500  |
| 3.  | KODI I PROCEDURËS PENALE             | 600  |
| 4.  | KODI PENAL                           | 400  |
| 5.  | KODI I PUNËS                         | 500  |
| 6.  | KODI I FAMILJES                      | 450  |
| 7.  | KODI CIVIL                           | 1000 |
| 8.  | KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN | 900  |
| 9.  | KODI ZGJEDHOR                        | 355  |
| 10. | DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR   | 1500 |

**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

|     |                                                            |      |
|-----|------------------------------------------------------------|------|
| 11. | PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT       | 800  |
| 12. | PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK | 1000 |
| 13. | KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE                          | 500  |
| 14. | PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL              | 600  |
| 15. | PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE               | 1500 |

**DOLI NGJA SHTYPI**

|                                                                 |      |
|-----------------------------------------------------------------|------|
| TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004 | 1500 |
| TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004     | 2000 |

Doli nga shtypi më 10.2.2005

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 4300 copë | Formati: 60x88/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë